

Përshëndetje nga ZIMBABVEJA!

Zimbabveja është në Afrikën Jugore. Atje jetojnë më shumë se 16 500 000 njerëz.

NJË UJËVARË E MAHNITSHME

Ujëvara Viktoria në Zimbabve është ujëvara më e madhe në botë. Zhurma mund të dëgjohet prej mbi 40 km larg.



KAFSHËT E MREKULLUESHME

Ka shumë toka livadhore në Zimbabve. Disa nga kafshët që jetojnë atje, janë luanët, hipopotamët, gjirafat, antilopat dhe elefantët.

NJË VIZITË NGA PROFETI

Në prill 2018 Presidenti Nelson dhe Motra Nelson vizituan Zimbabvenë. Qindra fëmijë kënduan për ta këngën "Fëmi' i Per'ndis' Jam".

Livukile!

Kjo do të thotë "Mirëmëngjes!" në ndebeleisht.

GJUHËT

Zimbabveja ka 16 gjuhë zyrtare. Disa nga këto gjuhë janë shonaisht, ndebeleisht dhe anglisht, thjesht për të përmendur disa.

Elefant me Punëdore

Zimbabveja ka popullatën e dytë më të madhe të elefantëve në botë.

1. Prit një rreth të madh letre për kokën dhe dy rrrathë më të vegjël për veshët. Pastaj ngjiti veshët te koka.
2. Prit një drejtkëndësh letre të gjatë që të bësh feçkën. Palose para-prapa që të bësh një formë fizarmonike.
3. Priti dy dhëmbët e elefantit.
4. Tani vizatoji sytë dhe një buzëqeshje për elefantin tënd. Më pas ngjiti dhëmbët dhe feçkën te koka!

VEPRIMTARIA



RECETA

Muriuo Unedovi (Barishte me Gjalpë Kikiriku)

Muriuo unedovi është një gjellë tradicionale në Zimbabve. Ja ku është një variant që mund ta provosh!

1. Prit në kubikë **1 qepë** dhe gatuaje në një tigan me **vaj** për 3-5 minuta. Prit në kubikë **2 domate** dhe shtoji në tigan. Gatuaje për 3-5 minuta të tjera.
2. Prit në copa **rreth 300 gram spinaq** (ose një lakër të egër sipas dëshirës) dhe shtoje në tigan. Lëri lakrat e egra t'u bjerë volumi për 5 minuta.
3. Shtoj **2 lugë gjelle (30 ml) gjalpë kikiriku**, **1/4 gotë (59 ml) me ujë** dhe **1/2 lugë çaji (2,4 ml) pluhur hudhre**. Përzieji mirë dhe shtoj **kripë** për shije.

Sigurohu që të marrësh ndihmë nga një i rritur.